



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS I AVOKATIT TË POPULLIT

për vizitat në stacionet policore

Për: Z. Agim Veliu, Ministër
Ministria e Punëve të Brendshme

Z. Rashit Qalaj, Drejtor i përgjithshëm
Policia e Kosovës

Kopje: Duda Balje, Kryetare

**Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe
Peticione**

09 shtator 2020

Hyrje

MKPT-ja, bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, si dhe institucionet psikiatrike dhe ato të kujdesit social.

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit, **nga 23 janari 2020 deri më 3 mars 2020, i ka vizituar stacionet policore në vijim: Veri dhe Jug në Prishtinë, Graçanicë, Fushë Kosovë, Obiliq, Mitrovicë Jugore, Mitrovicë Veriore, Prizren, Suharekë, Mamushë, Skenderaj, Drenas, Pejë, Vitomiricë, Gorazhdec, Deçan, Junik, Klinë, Istog, Ferizaj dhe Viti.**

Qëllimi i vizitës

Qëllimi i vizitës në stacionet policore ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të arrestuarve dhe të të ndaluarve, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin nr. 04/L-076 për Policinë, me Kodin e Procedurës Penale dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria e tyre.

Përbërja e grupit monitorues

Grupi monitorues përbëhej prej drejtorit të MKPT-së, një këshilltari të lartë juridik për parandalim të torturës, një këshilltare juridike për parandalim të torturës, një mjek-këshilltare, një psikologe-këshilltare dhe një punëtoreshë sociale-këshilltare.

Bashkëpunimi me MKPT-në gjatë vizitave

Gjatë vizitës në stacionet e lartpërmendura, Policia e Kosovës i ofroi MKPT-së bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje në të gjitha hapësirat në çdo stacion policor. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën dhe qasje në të gjitha dokumentet e kërkuara, si dhe iu mundësua intervistimi, pa praninë të zyrtarëve policorë, i personave të arrestuar.

Garancitë kundër keqtrajtimit

1. Të drejtat e personave të arrestuar nga policia e Kosovës janë të përcaktuar dhe të garantuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet në fuqi dhe me instrumentet ndërkombëtare të përfshira në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (RKS).
2. Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (KPT), në raportin e 2-të të Përgjithshëm, i publikuar në vitin 1992, ka theksuar rëndësinë e tri të drejtave themelore të personave të arrestuar nga policia, të cilat janë: e drejta për ta njoftuar personin e tretë sipas përzgjedhjes së tij/saj për arrestimin (anëtarin e familjes, mikun, konsullatën); e drejta për të pasur një avokat; e drejta për t'u ekzaminuar nga mjeku sipas dëshirës së tij (përveç ekzaminimit mjekësor nga një mjek i thirrur nga autoritetet policore).¹

¹ Shih: <https://rm.coe.int/16806cea2f/>

3. Sipas KPT-së, këto të drejta janë garanci themelore kundër keqtrajtimit fizik dhe duhet të zbatohen që nga momenti i parë i privimit nga liria, pa marrë parasysh se si përcaktohet në kuadër të sistemit ligjor të një vendi.
4. Legjislacioni në fuqi i Republikës së Kosovës këto të drejta themelore të personave të arrestuar dhe në mbajtje nga autoritetet policore i parasheh edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në Kodin e Procedurës Penale dhe në Ligjin për Policinë.
5. Neni 13 i Kodit të Procedurës Penale përcakton se çdo person i privuar nga liria duhet të njoftohet menjëherë, në gjuhën të cilën ai/ajo e kupton, për të drejtën për ndihmë juridike sipas dëshirës së tij, për të drejtën për t'i njoftuar anëtarët e familjes apo ndonjë person tjetër për faktin se është arrestuar dhe se këto të drejta aplikohen gjatë gjithë kohës së privimit nga liria.
6. Sa i përket njoftimit për arrestim, neni 168 i Kodit të Procedurës Penale më tej përcakton se personi i arrestuar ka të drejtë ta njoftojë anëtarin e familjes apo personin tjetër, sipas përzgjedhjes së tij, për arrestimin dhe vendin e ndalimit menjëherë pas arrestimit; njoftimi i familjarit apo i personit tjetër lidhur me arrestimin mund të vonohet më së shumti deri në 24 orë kur prokurori i shtetit çmon se kjo kushtëzohet me nevoja të jashtëzakonshme për hetim të rastit. Kjo vonesë nuk aplikohet në rastin e personave të mitur.
7. Sipas Ligjit për Policinë², e drejta për ta njoftuar familjen apo personin tjetër për arrestimin gjithashtu vlen edhe për personat të cilët janë në “*ndalim të përkohshëm*”, me qëllim të identifikimit ose për shkak të mbrojtjes së tyre dhe mbrojtjes së të tjerëve.
8. Sipas Kodit të Procedurës Penale, neni 13, paragrafi 2.3, neni 163, paragrafi 2, neni 164, paragrafi 5, ndaj personave të dyshuar përcakton se koha e ndalimit policor në qendrat e ndalimit nuk duhet të kalojë më shumë se dyzet e tetë orë (48) nga koha e arrestimit të tij, përveç rasteve kur gjyqtari i procedurës paraprake urdhëron ndryshe. Sipas neni 60 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, ndalimi i të miturit nuk mund të kalojë periudhën njëzet e katër orë (24), dhe pas kalimit të kësaj periudhe, i mituri duhet të lirohet, përveç nëse gjyqtari për të mitur cakton paraburgim.³
9. Sa i përket së drejtës në avokat, personi i ndaluar/arrestuar në bazë të nenin 166 të Kodit të Procedurës Penale, ka të drejtë për ndihmë të menjëhershme të mbrojtësit pas arrestimit të tij, sipas zgjedhjes së tij⁴. Mirëpo kur pësoni i arrestuar nuk angazhon mbrojtës, atij i sigurohet mbrojtësi me shpenzime publike.⁵ Po ashtu, personi i ndaluar mund të heqë dorë nga ndihma e mbrojtësit, kjo e drejtë mund të hiqet në bazë të nenit 53, paragrafi 3, të Kodit të Procedurës Penale: “*Nga e drejta për të pasur mbrojtës mund të hiqet dorë, përveç në rastin e mbrojtjes së detyruar, nëse heqja dorë bëhet qartë dhe vullnetarisht pas informimit të plotë për të drejtën e tij në mbrojtje. Heqja dorë duhet bërë me shkrim dhe duhet nënshkruar nga i dyshuari apo i pandehuri dhe nga organi kompetent që e zbaton procedurën, ose mund të bëhet gojarisht në audio apo videokasetë, autenticiteti i të cilës verifikohet nga gjykata.*”
10. Ndërsa personat nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç mund të heqin dorë nga e drejta për të angazhuar mbrojtës me pëlqimin e prindit, të kujdestarit ose të përfaqësuesit nga

² Ligji për Policinë, neni 20.

³ Kodi i Drejtësisë për të Mitur, neni 60.

⁴ Kodi i Procedurës Penale, neni 166, paragrafi 1.

⁵ Kodi i Procedurës Penale, neni 166, paragrafi 2.

qendra për punë sociale, përveç rasteve të dhunës në familje, në të cilat është përfshirë prindi ose kujdestari, raste këto tek të cilët prindi ose kujdestari i tillë nuk mund të japin pëlqim për heqjen dorë nga kjo e drejtë⁶.

11. Lidhur me të drejtën për kontroll mjekësor të personave të arrestuar/ndaluar, neni 169 i Kodit të Procedurës Penale përcakton se personi i arrestuar/ndaluar ka të drejtë për kontroll mjekësor sipas kërkesës së tij të kontrollohet nga mjeku apo nga dentisti, sipas zgjedhjes së tij.⁷ Po ashtu kur personi i arrestuar tregon shenja të sëmundjes mendore, policia menjëherë mund të urdhërojë kontrollimin nga një psikiatër.⁸
12. Ndërsa kur person i arrestuar është shtetas i huaj, sipas nenit 167 të Kodit të Procedurës Penale, ka të drejtë ta njoftojë dhe të komunikojë gojarisht apo me shkrim me ambasadën, me zyrën ndërlidhëse apo me misionin diplomatik të shtetit, shtetas i të cilit është ai, ose me përfaqësuesin e organizatës kompetente kur ai është refugjatë ose nën mbrojtjen e ndonjë organizate ndërkombëtare⁹.
13. MKPT-ja, gjatë vizitave në stacionet policore të lartcekura nuk mori ankesa nga personat e arrestuar dhe të ndaluar, të cilët i ka intervistuar lidhur me mosrespektimin e këtyre të drejtave themelore, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin nr. 04/L-076 për Policinë, me Kodin e Procedurës Penale dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria e tyre.

Dosjet e të arrestuarve

14. Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar gjatë vizitave në stacionet policore të lartpërmendura, MKPT-ja ka vërejtur se të gjitha stacionet policore e kanë dokumentin standard (dosjen e të arrestuarit/ndaluarit), në të cilin regjistrohen të gjitha të dhënat lidhur me të arrestuarin, në pajtim me nenin 172 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.
15. Përveç kësaj, MKPT-ja ka vërejtur se në secilin stacion policor kishte dokumente konkrete shtesë, në të cilat autoritetet policore kishin evidentuar me përpikëri çdo ngjarje lidhur me personin e arrestuar. Po ashtu, MKPT-ja ka hasur edhe në raste kur zyrtarët policorë, përgjegjës për qelitë e mbajtjes, me iniciativën e tyre kanë përpiluar program kompjuterik për mbajtjen e të dhënave për personat e arrestuar. Kjo praktikë nuk është unike në nivel të vendit.

Keqtrajtimi fizik

16. MKPT-ja, gjatë vizitave në stacionet policore e lartpërmendura, ka hasur në persona të arrestuar në Qendrën Rajonale të Mbrojtjes në Prishtinë, në stacionet policore: Pejë, Ferizaj, Prizren, Drenas, të cilët janë intervistuar nga ekipi i MKPT-së. Gjatë intervistimit, MKPT-ja nuk ka marrë pohime për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët policorë gjatë kohës së arrestimit. MKPT-ja i ka shqyrtuar dosjet e të arrestuarve ku u evidentua se të arrestuarit janë vizituar nga mjeku

⁶ Kodi i Procedurës Penale, neni 53, paragrafi 5.

⁷ Kodi i Procedurës Penale, neni 169, paragrafi 1.

⁸ Kodi i Procedurës Penale, neni 169, paragrafi 4.

⁹ Kodi i Procedurës Penale, neni 167, paragrafët 1 dhe 2.

dhe në fletë-kontrollin mjekësor është shënuar matja e shenjave vitale dhe udhëzimet e tjera terapeutike të nevojshme.

Kushtet fizike në këto stacione policore

17. Procedura Standarde të Operimit përcakton se qendrat e ndalimit duhet të jenë në përputhshmëri me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe me Rekomandimet e Komitetit për Parandalim të Torturës duke u bazuar në Konventën Kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore jo Njerëzore dhe Poshtëruese¹⁰.
18. Po ashtu, MKPT-ja vëren se KPT-ja në raportin e 2-të të Përgjithshëm, i publikuar më 13 prill 1992 në Strasburg, ka përcaktuar standardin lidhur me kushtet në qelitë ku mbahen të arrestuarit, i cili përcakton: *“Të gjitha qelitë në stacione policore duhet të jenë të madhësisë së arsyeshme për numrin e personave të akomoduar, duhet të kenë ndriçim adekuat (shembull, dritë e mjaftueshme për të lexuar, me përjashtim të periudhave të fjetjes) dhe ventilim dhe të jenë të pajisura me karrige të fiksuar ose tavolinë). Për më shumë, personat të cilët qëndrojnë në ndalim gjatë natës duhet t’u sigurohen çarçafë dhe batanije të pastra.”*¹¹
19. **Qendra Rajonale e Mbajtjes në Prishtinë është vizituar nga MKPT-ja më 23 janar 2020.** MKPT-ja gjatë vizitës ka vërejtur se qelitë ku akomodohen të ndaluarit ishin të pastra, po ashtu kishin dyshekë dhe çarçafë të pastër. Gjithashtu hapësira për person në qeli është sipas standardeve të KPT-së. Sa i përket ndriçimit, dhomat e ndalimit kanë dritë artificiale, por kanë mungesë të dritës natyrale. Ndërsa sistemi i ventilimit është funksional, po ashtu kamerat e sigurisë në këtë stacion janë funksionale.
20. MKPT-ja gjatë vizitës është njoftuar se të arrestuarit/ndaluarit në këtë qendër nuk mund të bëjnë dush, po ashtu nuk kanë mjete higjienike.
21. Ashtu si në vizitat e tjera në këtë qendër të ndalimit, MKPT-ja ka vërejtur se kushtet e punës të zyrtarëve policorë nuk janë të mira, pasi që ndërtesa është shumë vjetër dhe ka mungesë të dritës natyrale, ndërsa gjatë dimrit është shumë ftoftë dhe ka lagështi. **MKPT-ja konsideron se autoritetet relevante duhet të ndërmarrin hapa të nevojshëm për përmirësimin e kushteve të punës për zyrtarët policorë të kësaj qendre.**
22. **Stacionet Policore “JUG” dhe “VERI” në Prishtinë u vizituan nga MKPT-ja më 28 janar 2020.** Stacioni policor “JUG” gjendet në ish-hotelin “Victory”, i cili nuk i plotëson kushtet për të qenë stacion i mirëfilltë policor, është thjesht improvizim. Dhomat e intervistimit në këtë stacion nuk ofrojnë konfidencialitet, pasi që intervistimi mund të dëgjohet edhe në dhomat e tjera. Kamerat e sigurisë në këtë stacion mbulojnë vetëm hapësirat e jashtme të objektit dhe në hollin e katit përdhese, ndërsa pjesët e tjera nuk mbulojnë me kamera. Personat e arrestuar/ndaluar në këtë stacion mbahen vetëm deri në gjashtë orë pastaj dërgohen në stacionet e tjera ku ka qendra të ndalimit.

¹⁰ Policia e Kosovës, Procedurat Standarde të Operimit për Qendrat e Ndalimit, DDO-04/0121/2016, pika 1.6, faqe 4.

¹¹ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 2-të i Përgjithshëm, paragrafi 42. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/1680696a3f..>

23. Ndërsa **Stacioni Policor “VERI”** është i vendosur në kontejnerë me kushte nën minimale për punë për zyrtarët policorë. Kontejnerët janë të vendosur që nga vitin 1999 nga KFOR-i. Zyrrat në objektin e vjetër janë të dëmtuara dhe kundërmojnë erë myku gjithandej, shpesh ka edhe gjallesa si minj. E gjithë kjo zyrtarëve policorë u paraqet shumë vështirësi në kryerjen e punës. Në këtë stacion nuk ka dhomë miqësore në rast të dhunës në familje dhe intervistimit të të miturve.
24. **Stacioni Policor në Fushë Kosovë është vizituar nga MKPT më 30 janar 2020.** MKPT-ja vërejti se ky stacion përballet me kushte të rënda infrastrukturore dhe me kushte minimale për punë për zyrtarët policorë. Gjatë vizitës në këtë stacion, MKPT-ja vërejti se më ditë të tëra ky stacion përballet me mungesë të ujit, gjë që edhe më shumë e vështirësonte punën e zyrtarëve policorë.
25. **MKPT-ja e Avokatit të Popullit**, me Letër Rekomandimin e datës 15 dhjetor 2019, i ka rekomanduar Policisë së Kosovës që ta rinovojë Stacionin Policor në Fushë Kosovës apo të gjejë ndonjë zgjidhje për këtë stacion.¹²
26. **Stacioni Policor në Obiliq është vizituar nga MKPT-ja më 4 shkurt 2020.** Në lidhje me kushtet fizike në këtë stacion, MKPT-ja konsideron se janë shume të mira. Ky stacion posedon qendrën e ndalimit, mirëpo kjo qendër nuk është funksionale. Sipas komandantit, do të ishte e mirëseardhur që kjo qendër të rinovohej dhe të funksionalizohej, pasi që të arrestuarit duhet t’i dërgojnë në mbajtje në Qendrën e Mbajtës në Prishtinë, në Lipjan dhe në Podujevë, dhe kjo po u shkakton vështirësi në kryerjen e punës.
27. **Stacioni Policor në Graçanicë është vizituar nga MKPT-ja më 5 shkurt 2020.** Qendra e mbajtjes në këtë stacion nuk është funksionale, personat e arrestuar/ndaluar në këtë stacion mbahen deri në gjashtë orë. MKPT-ja gjatë vizitës vërejti se stacioni policor në Graçanicë është në gjendje të mirë sa i përket kushteve fizike.
28. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT) e ka vizituar Stacionin Policor në Graçanicë në vitin 2015¹³ dhe ka konstatuar përmirësime të dukshme në lidhje me kushtet e akomodimit dhe ish-in korrigjuar pjesa më e madhe e mangësive të vërejtura gjatë vizitave të mëparshme.
29. **Stacioni policor në Mitrovicën e Jugut është vizituar nga MKPT-ja më 6 shkurt 2020.** Gjatë vizitës, MKPT-ja vizitoi qendrën e mbajtjes, e cila, në pikëpamje të ndriçimit të hapësirës për të ndaluarit dhe në aspekte të tjera, i plotëson të gjitha standardet e parapara me PSO dhe me standardet e përcaktuar nga KPT-ja. MKPT-ja vërejti se qendra e ndalimit vëzhgohet nga kamerat e sigurisë.
30. **Stacioni Policor në Suharekë është vizituar nga MKPT-ja më 7 shkurt 2020.** Sa i përket Qendrës së Ndalimit në Stacionin Policor në Suharekë, MKPT-ja konsideron se kushtet fizike janë në pajtim me PSO dhe me standardet ndërkombëtare, respektivisht me standardet e KPT-së. Dhomat e ndalimit kishin hapësirë të mjaftueshme për një person sipas rekomandimeve të KPT-së. Po ashtu dhomat e ndalimit posedonin ndriçim të mjaftueshëm natyral dhe artificial, dyshekë, mbulesa dhe çarçafë të pastër.

¹² Letër rekomandimi i MKPT-së për vizitat në stacione të ndryshme policore në Kosovë. Shih në <https://www.oik-rks.org/2019/12/17/leter-rekomandimi-i-mkpt-se-per-vizitat-ne-stacione-policore-ne-kosove/>

¹³ Shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>.

31. MKPT-ja vërejti dhe po ashtu u njoftua edhe nga zyrtarët policorë se Qendra e Ndalimit në Suharekë nuk posedon një dhomë ku i ndaluari mund të komunikojë me avokatin në mënyrë konfidenciale.
32. Sipas Kodit të Procedurës Penale, nenit 166, para. 3, personi i arrestuar/ndaluar ka të drejtë në qendrën e ndalimit të komunikojë gojarisht dhe me shkrim në mënyrë konfidenciale me mbrojtësin e tij. Komunikimi ndërmjet të arrestuarit dhe mbrojtësit, sipas PSO-së, mund të vëzhgohet, por jo të dëgjohet nga zyrtari policor.
33. **Stacioni Policor në Mamushë është vizituar nga MKPT-ja më 7 shkurt 2020.** Sa i përket dhomave të ndalimit në këtë stacion, ato nuk janë funksionale dhe nuk përdoren. Ndërsa lidhur me kushtet e punës, MKPT-ja vërejti se janë të vështira për shkak të hapësirës shumë të vogël. Sipas zyrtarëve policorë, është caktuar objekti i ri ku do të ndërtohet stacioni i ri policor i Mamushës. MKPT-ja mirëpret informacione shtesë nga Policia e Kosovës lidhur me planifikimin që ky stacion policor të vendoset në ndonjë lokacion tjetër.
34. **Stacioni Policor në Prizren është vizituar nga MKPT-ja më 7 shkurt 2020.** MKPT-ja vërejti se qendra e mbajtjes, sa i parkete hapësirës, është në pajtim me rekomandimet e KPT-së dhe PSO-së. Ndërsa sa i parkete pastërtisë ishte në nivelin e duhur por dyshekët ishin pa çarçafë dhe muret ishin të pa gëlqerosura. MKPT-ja në këtë stacion i vizitoi edhe dhomat e intervistimit, të cilat ishin në gjendjen të mirë. Po ashtu MKPT-ja vizitoi dhomën në të cilën intervistohen rastet e dhunës në familje dhe dhomën për intervistimin e të miturve, të cilat ishin të rregulluara me një pamje të këndshme.
35. **Stacioni Policor në Drenas është vizituar nga MKPT-ja më 11 shkurt 2020.** Qendra e Ndalimit në këtë stacion është funksionale dhe në kuptim të hapësirës, pastërtisë, ventilimit, ndriçimit natyral dhe artificial i plotëson standardet minimale të KPT-së dhe të PSO-së. Mirëpo zyrtarët policorë shprehën drojën e tyre lidhur me poqët elektrikë në dhomat e mbajtjes, të cilat mund të jenë të qasshme për të arrestuarit dhe kanë drojën nga ndonjë tentim për t'u vetëlënduar apo për t'u vetëvlarë.
36. **Stacioni Policor në Skenderaj është vizituar nga MKPT-ja më 11 shkurt 2020.** Ky stacion policor nuk posedon qeli të mbajtjes për personat e arrestuar. Të arrestuarit mbahen në zyrën e intervistave deri në 6 orë, ndërsa për mbajtje të mëtejme sipas urdhrit të prokurorit, të arrestuarit dërgohen në Qendrën e Mbajtjes në Mitrovicën e Jugut. Sa i përket kushteve fizike të stacionit, MKPT-ja vërejti se ky stacion ka nevojë për renovim.
37. **Drejtoria Rajonale e Mitrovicës Veriore është vizituar nga MKPT-ja më 13 shkurt 2020.** Kjo drejtori mbulon stacionet policore në Mitrovicë-Veri, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok. Qendra e Mbajtjes është funksionale vetëm në Leposaviq. Gjatë vizitës nuk pati persona të arrestuar. Të ndaluarit dërgohen në qendrat e ndalimit të stacioneve policore Mitrovica-Jug dhe Leposaviq. MKPT-ja e vizitoi edhe dhomën ku intervistohen rastet e dhunës në familje, e cila kishte një pamje të përshtatshme për qëndrim të fëmijëve.
38. Objekti i këtij stacion nuk është pronë e Policisë së Kosovës, por është një objekt i improvizuar në pronësi të ndërmarrjes publike "TREPÇA". Kushtet e punës për zyrtarët policorë nuk janë adekuate dhe nevojiten rinovime.

39. **Stacioni Policor në Pejë është vizituar nga MKPT-ja më 20 shkurt 2020.** Gjatë vizitës në stacionin policor në Pejë, MKPT-ja ka vizituar qendrën e mbajtës dhe ka vërejtur se qelitë ku mbahen të arrestuarit ofrojnë kushte të mira të akomodimit, të cilat, sa u përket dritës artificiale dhe natyrale, madhësisë, pastërtisë dhe ventilimit, janë në pajtim me PSO-në dhe me standardet e KPT-së.¹⁴ Po ashtu objekti dhe dhomat e ndalimit janë nën vëzhgimin e kamerave.
40. Sa u përket rekomandimeve të MKPT-së gjatë vitit 2019 për vizitat në stacione të caktuara policore,¹⁵ MKPT-ja ka vërejtur se këto rekomandime në Qendrën e Mbajtjes në Pejë janë zbatuar për aq sa ka pasur mundësi të intervenohet në atë objekt.
41. **Nënstacioni Policor Gorazhdec funksion në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Policisë së Pejës dhe është vizituar nga MKPT-ja më 20 shkurt 2020.** Sa u përket kushteve të punës të zyrtarëve policorë, ato ishin shumë të vështira, nën minimale, pasi që ky nënstacion është i vendosur në kontejnerë të instaluar nga UNMIK-u në vitin 1999. MKPT-ja u njoftua nga komandanti i nënstacionit se vazhdimisht ka bërë kërkesa për ndërtimin e një objekti apo kalimin në ndonjë objekt më të përshtatshëm, mirëpo nuk ka marrë ndonjë përgjigje. Sa u përket të arrestuarve, ata i dërgojnë menjëherë në Stacionin Policor të Pejës, pasi që aty nuk ka kushte adekuate për t'u intervistuar.
42. **Nënstacioni Policor në Vitomiricë funksion në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Policisë së Pejës dhe është vizituar nga MKPT-ja më 20 shkurt 2020.** Nënstacioni Policor i Vitomiricës është i vendosur në një objekt të vjetër dhe nuk i plotëson kushtet minimale të punës për zyrtarët policorë. Sa u përket të ndaluarve, ata nuk mbahen në këtë stacion, vetëm sa t'u përgatiten dosjet dhe dërgohen në Stacionin Policor të Pejës. Sipas komandantit, në këtë nënstacion intervistohen vetëm të dëmtuarit dhe dëshmitarët. MKPT-ja ka vërejtur se dhomat e intervistimit nuk ofronin konfidencialitet, pasi që intervistimi mund të dëgjohej edhe në zyrat e tjera.
43. **Stacioni Policor në Deçan është vizituar nga MKPT-ja më 25 shkurt 2020.** Gjatë vizitës, MKPT-ja vërejtiti se nuk ka ndryshime në stacionin policor krahasuar me vërejtjet gjatë vizitave të mëparshme. Qelitë ku mbahet të ndaluarit nuk kanë dritë natyrale, por kanë dritë artificiale. Shqetësuese janë llambat të cilat ndodheshin në qeli, të cilat ka mundësi të kapen nga personat në mbajtje, të cilët synojnë eventualisht t'i shkaktojnë vetes dëme.
44. MKPT-ja, edhe përmes raportit me rekomandime, i publikuar më 16 tetor 2018, e ka konstatuar të njëjtën gjendje. Po ashtu përmes Letër rekomandimit, më 15 dhjetor 2019, i ka ripërsëritur rekomandimet e dhëna për këtë qendër pasi rekomandimet e mëhershëm nuk janë zbatuar¹⁶.
45. **Stacioni Policor në Junik është vizituar nga MKPT-ja më 25 shkurt 2020.** Ky stacion policor nuk posedon qeli të mbajtjes për personat e arrestuar. Të arrestuarit mbahen në zyrën e intervistave deri në 6 orë, ndërsa për mbajtje të mëtejme sipas urdhrorit të prokurorit, të arrestuarit dërgohen në qendrat e tjera të mbajtjes.

¹⁴ Shih: <https://rm.coe.int/16806cea2f>.

¹⁵ Shih linkun: <https://www.oik-rks.org/2019/12/17/leter-rekomandimi-i-mkpt-se-per-vizitat-ne-stacione-policore-ne-kosove/>.

¹⁶ Shih linkun: <https://www.oik-rks.org/2019/12/17/leter-rekomandimi-i-mkpt-se-per-vizitat-ne-stacione-policore-ne-kosove/>

46. **Stacioni Policor në Klinë është vizituar nga MKTP-ja më 27 shkurt 2020.** MKPT-ja ka vërejtur se kushtet fizike dhe të akomodimit në këtë stacion, sa u përket hapësirës ndriçimit natyral, artificial dhe higjienës, janë në pajtim me PSO-në dhe me standardet e KPT-së.
47. **Stacioni Policor në Istog është vizituar nga MKPT-ja më 27 shkurt 2020.** Lidhur me kushtet fizike të zyrtarëve policorë në këtë stacion, MKPT-ja konsideron se ishin të mira. Ndërsa qelitë në qendrën e mbajtjes në përgjithësi i plotësonin standardet minimale për akomodim të personave të arrestuar, ka dritë natyrale dhe artificiale, madhësia e qelive është në pajtim me standardet e KPT-së¹⁷ dhe PSO-së. Mirëpo sipas zyrtarit policor, ventilimi në qendrën e mbajtjes nuk është funksional.
48. **Stacioni Policor në Ferizaj është vizituar nga MKPT-ja më 3 mars 2020.** Kushtet fizike dhe të punës të zyrtarëve policorë në Stacionin Policor në Ferizaj kryesisht ishin të mira. Sa i përket qendrës së mbajtjes, qelitë ku mbaheshin personat e arrestuara kishin dritë natyrale dhe artificiale, kushtet higjienike ishin të mira dhe në pajtim me standardet e KPT-së. Po ashtu qendra e mbajtjes kishte dhomën ku i ndaluar mund të bisedonte në mënyrë konfidenciale me mbrojtësin e tij. MKPT-ja ka vërejtur se ky stacion në përgjithësi i plotëson standardet minimale për akomodim të personave të arrestuar.
49. **Stacioni Policor në Viti është vizituar nga MKTP-ja më 3 mars 2020.** Gjate vizitës, MKPT-ja vërejti se kushtet e punës të zyrtarëve policorë nuk ishin adekuate për punë, pasi që objekti i këtij stacioni ishte shumë i vjetër dhe i demoluar. Ndërsa qelitë në qendrën e mbajtjes ku mbahen të arrestuarit ofronin kushte të mira të akomodimit, përfshirë dritën artificiale dhe natyrale, pastërtinë dhe ventilimin. Po ashtu madhësia e qelive ishte në pajtim me standardet e KPT-së¹⁸.
50. **MKPT-ja i ka vizituar edhe dhomat e intervistimit në të gjitha stacionet e lartcekura dhe nuk hasi në objekte apo në mjete të forta.** Po ashtu MKPT-ja vërejti se dhomat e intervistimit në shumicën e stacioneve ishin në gjendje të mirë.
51. **Në të gjitha stacionet e vizituara, MKPT-ja ka vërejtur se të arrestuarit nuk furnizohen me mjete higjienike personale.** MKPT-ja konsideron se autoritetet relevante duhet të ndërmarrin hapa konkret për t'i pajisur qendrat e mbajtjes me mjete higjienike.
52. Gjate vizitës, MKPT-ja vërejti se asnjëri nga stacionet e vizituara nuk ka **sistem të thirrjes**. MKPT-ja vëren se KPT-ja në raportet për Kosovën për vizitën në vitin 2015, u ka rekomanduar autoriteteve kompetente në Kosovë që qelitë në stacionet policore të pajisen me sistem të thirrjes, gjë që të arrestuarve do t'u mundësonte kontakt më të lehtë me zyrtarët policorë në rast nevojë.¹⁹

Regjimi

53. Neni 170, paragrafi 4, i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës shprehimisht përcakton: *“Brenda njëzet e katër (24) orëve, personi i arrestuar ka të drejtë në së paku tetë (8) orë pushim pa ndërprerje dhe gjatë kësaj kohe nuk merret në pyetje e as nuk trazohet nga policia lidhur me hetimin.”*

¹⁷ Shih: <https://rm.coe.int/16806cea2f>.

¹⁸ Shih: <https://rm.coe.int/16806cea2f>.

¹⁹ Raporti i KPT-së për vizitën në Kosovë në vitin 2015, përgjigja e autoriteteve. Shih në: <https://www.coe.int/en/web/cpt/kosovo>.

54. Po ashtu, në raportin e 12-të të Përgjithshëm, i publikuar në vitin 2002, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës kishte theksuar se personave të cilët mbahen në arrest në polici më shumë se 24 orë, duhet që brenda mundësive t'u ofrohet ajrosje ditore (dalje në ajër të pastër).²⁰ MKPT-ja u njoftua nga zyrtarët policorë në stacionet e vizituara se të arrestuarve nuk u ofrohet ajrosja as kur qëndrojnë aty edhe më shumë se 24 orë, pasi që nuk kanë kushte fizike.
55. MKPT-ja gjatë vizitave në stacionet e lartpërmendura ka vërejtur se asnjëra nga këto stacione të arrestuarve nuk u ofron ajrosje gjatë 24 orëve të qëndrimit, përpos stacionit policor në Viti, që të arrestuarve u ofron një ajrosje të shkurtër në hollin e stacionit policor nën përcjelljen e drejtpërdrejtë të zyrtarëve policorë. MKPT-ja konsideron se në pajtim me standardet e KPT-së, autoritetet kompetente, sa herë që kjo të jetë e mundur, duhet t'u sigurojnë të ndaluarve ajrosje jashtë qelisë edhe në stacionet e tjera policore ku të arrestuarit mbahen më gjatë se 24 orë.

Kujdesi shëndetësor

56. Sa u përket shërbimeve mjekësore, si e drejtë themelore, personave të cilët arrestohen nga policia, këto shërbime u ofrohen nga institucionet publike, siç janë: qendra e mjekësisë familjare dhe Qendra Klinike Universitare, varësisht nga nevojat për trajtim. MKPT-ja nuk ka marrë ankesa nga personat e intervistuar lidhur me këtë të drejtë. Po ashtu, nga dokumentacioni i shqyrtuar është vërejtur se policia ka evidentuar në dosjet e tyre personale njoftimin për të drejtën për të pasur shërbime mjekësore.

Ushqimi

57. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës përcakton obligimin që, nëse personi i privuar nga liria mbahet më shumë se 12 orë, duhet t'i sigurohen tri racione ushqim në ditë.²¹ Personave të arrestuar, të cilët dërgohen në mbajtje, u ofrohen tri racione ushqim brenda 24 orëve, sipas kontratës që ka Policia me kompaninë kontraktuese. MKPT-ja u njoftua nga zyrtarët policorë se të tri racionet ushqimore janë të njëjta (byrek, jogurt). **Po ashtu në stacionin policor të Pejës, MKPT-ja u njoftua se ushqimi, përpos që është i njëjtë në të tri racionet, nuk është edhe i bollshëm për nga sasia.**

Parashtrimi i ankesave nga personat e arrestuar

58. Lidhur me trajtimin e tyre nga Policia e Kosovës, personat e arrestuar kanë të drejtë të parashtrajnë ankesa në stacionin policor ku mbahen, në Inspektoratin Policor të Kosovës, si dhe tek organet e jashtme monitoruese, siç janë: MPKT-ja dhe organizatat joqeveritare, të cilave u lejohen vizitat në vendet e privimit nga liria. Për t'u ofruar qasje më të lehtë në shërbimet e këtij institucioni dhe për t'ua mundësuar të arrestuarve parashtrimin e ankesave në mënyrë konfidenciale, Avokati i Popullit ka vendosur kuti të ankesave në stacionet policore ku ekzistojnë qelitë për mbajtje të të arrestuarve. Këto kuti të ankesave mund të hapen vetëm nga personeli i caktuar i Avokatit të Popullit.

²⁰ Raporti i 12-të i Përgjithshëm i KPT, paragrafi 47, në: <https://rm.coe.int/16806cd1ed>

²¹ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 170 paragrafi 3.

Prandaj, bazuar në të gjeturat gjatë vizitës, Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit i


REKOMANDON

Policisë së Kosovës:

- **MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që të kryhen rinovimet e nevojshme në qendrën e mbajtjes në Deçan, sa më shpejt që të jetë e mundur.**
- **MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që, në të gjitha qelitë në stacione policore ku ka dhoma të mbajtjes, të instalohen sistemet e thirrjeve aty ku mungojnë.**
- **MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që të ndaluarit të furnizohen me mjete higjienike dhe me çarçafë.**
- **MKPT-ja rekomandon që të kryhen rinovimet e nevojshme në Qendrën e Mbajtës në Stacionin Policor në Prizren.**
- **Të krijohet hapësirë e duhur në Qendrën e Mbajtjes në Stacionin Policor në Suharekë, ku të ndaluarit mund të komunikojnë me mbrojtësin/avokatin në mënyrë konfidenciale.**
- **Të ndaluarve për më shumë se 24 orë, brenda mundësive, t'u ofrohet dalje në ajër të pastër.**
- **Të ndaluarve t'u ofrohet ushqim më cilësorë dhe të rritet sasia e ushqimit.**
- **Të gjendet ndonjë zgjidhje tjetër e cila është adekuate për punë për Stacionin Policor Veriu në Prishtinë dhe për Nënstacionin Policor të Gorazhdec, sa më shpejt që të jetë e mundur.**
- **Të rinovohen apo të gjendet ndonjë zgjidhje tjetër për stacionet policore: Jugu në Prishtinë, Fushë Kosovë, Mamushë, Skenderaj, Mitrovicë Veriore, Vitomiricë dhe Vitisë.**

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,



Hilmi Jashari

Avokat i Popullit